



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL

“I HEDHJES SË SHORTIT MANUAL”

I mbajtur sot me datë 21.09. 2019 ora 12.50, nga sekretare Ermelinda Kadiu, në prani të:

1. Ardian Dvorani (kryetar)
2. Vitore Tusha (zëvendës kryetare)
3. Arta Marku (anëtare)
4. Fatri Islamaj (anëtar)
5. Eriol Roshi (anëtar)
6. Fatjona Memçaj (anëtare)
7. Margarita Buhali (anëtare)

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, përfaqësues i Avokatit të Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani deklaroi fillimin e procedurës për hedhjen e shortit për caktimin e anëtarit të Këshillit relator për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Kuvendi në datën 21.08.2019, si edhe për caktimin e këshilltarëve që punojnë secili me aktet për kandidatë në mbështetje të veprimtarisë së anëtarit të Këshillit relator të kësaj vakance.

Në short do të procedohet në këtë mënyrë, pra do të shortohen 5 (pesë) nga 7 (shtatë) anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për arsyen se anëtarja Fatjona Memçaj nuk mund të marri pjesë si relatore, nuk mund të jetë relatore, ajo nuk do të marri pjesë praktikisht në procedurën e verifikimit dhe vlerësimit të njëjës prej kandidatëve Ardita Arsula, për shkak të marrëdhënieve familjare. Është një fakt që na ka ndodhur edhe në fillim kur kemi filluar procedurat e vlerësimit, kështu që edhe me cilësinë time si kryetar i Këshillit ajo është e përjashtuar me vendimmarrjen përkatëse që ka marrë nga ky short. Njëkohësisht nga bisedimi dhe paraparak, Këshilli ka vlerësuar që meqenëse anëtarja Margarita Buhali është në proces të shqyrtimit të kandidaturave për vendin vakant Inspektor i Lartë i Drejtësisë dhe tashmë kanë mbërritur edhe të paktën 4 (katër) kandidatura, thjesht po presim nëse posta do na sjelli ndonjë tjetër. Pra do të ketë ngarkesën për të proceduar me verifikimin e kandidaturave të vendit vakant Inspektor i Lartë i Drejtësisë edhe ajo të mos përfshihet në short, pra të jemi vetëm 5 (pesë) anëtarët e tjerë. Dhe në këtë radhë do të procedohet me short manual. Raportin teknik e kemi ripërtërirë nga teknika e Gjykatës së Lartë, situata nuk ka ndryshuar, nuk ka pasur ndonjë zhvillim teknologjik tjetër Gjykata e Lartë, kështu që jemi të detyruar të përdorim shortin manual, njësoj si herën e kaluar. Kurse për sa i përket këshilltarëve, sugjerojmë që meqenëse kemi 1 (një) vakancë dhe ne kemi në dispozicion 3 (tre) këshilltarë për të mundësuar procedurën sa më të shpejtë të punës së përgatitjes së akteve të verifikimit dhe më pas të vlerësimit të 3 (tre) këshilltarët të përfshihen në punë së bashku me relatorin, duke i ndarë me emrat e kandidatëve.

Në fillim do të vendosni në vazo emrat e anëtarëve të Këshillit dhe më pas tërhiqni një gogël.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ dhe sipas shortit është emri i anëtarit të Këshillit Fatri Islamaj.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani deklaron se në bazë të shortit, relator për vendin vakant do të jetë anëtari i Këshillit zoti Fatri Islamaj.

Ju lutem procedoni me vendosjen në kutitë të emrave të këshilltarëve dhe atyre të gjashtë kandidatëve.

Shortimi bëhet në këtë mënyrë, së pari njëherë hapet një emër kandidati ose kandidateje dhe pastaj një emër këshilltari.

Tërhiqen goglat nga punonjësit administrativ, sipas orientimit të Kryetarit të Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani deklaron se sipas rezultatit të shortit, relator për trajtimin e kandidaturave për këtë vend vakant është zoti Fatri Islamaj.

Për sa i përket këshilltarëve, sipas ndarjes së punës së bërë me short, për kandidaten Ardita Arsula është këshilltari Florjan Kalaja, për kandidaten Regleta Panajoti është këshilltari Sajmir Nazifi, për kandidatin Klodjan Rado është këshilltari Besmir Rrapaj, për kandidatin Ded Kasneci është këshilltari Sajmir Nazifi, për kandidatin Shaqir Hasani është këshilltari Florjan Kalaja dhe për kandidaten Vjosa Bodo është këshilltari Besmir Rrapaj.

Ky është rezultati i shortit dhe sigurisht relatorët japin udhëzimet përkatëse që të filloj menjëherë procedura e njoftimit, që javën e ardhshme apo brenda 5 (pesë) ditëve kandidatët të paraqiten për të bërë procedurat përkatëse.

Rezultati i shortit bëhet publik dhe është pjesë komunikatës për median për mbledhjen e sotme.

Procedura e shortit deklarohet e përfunduar.

MBYLLET PROCEDURA E SHORTIT

Sekretare

Ermelinda KADIU

Kryetar

Ardian DVORANI